UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.13, datë 15.6.2010

MBI DISA NDRYSHIME E SHTESA NË UDHËZIMIN NR.6257, DATË 2.9.2008 "MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 25 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane", i ndryshuar, dhe bazuar në pikat 3 e 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.600, datë 12.9.2007 "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë",

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1.Në pikën 7/1 bëhen këto ndryshime:

a) Shprehja "dhe që nuk janë verifikuar në terren nga Enti Kombëtar i Banesave" hiqet;

b) germa "a" ndryshon si vijon:

"Vërtetim negativ nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron banesë e regjistruar ose në proces regjistrimi";

c) Germa "b", ndryshon si vijon:

"Vërtetimin për përfitimin e statusit "banor në ish-pronë private", miratuar me vendim të këshillit bashkiak, përpara vitit 2006";

d) Në fund të fjalisë në germën "c", shtohet togfjalëshi "dhe atë aktuale";

"7/2. Qytetarët të cilët nuk janë përfshirë në listat e dërguara nga bashkitë përkatëse, e respektivisht nuk kanë përfituar statutin me vendim të këshillit bashkiak, për t'u përfshirë në programin e kreditimit me interes 0% duhet që, përveç dokumentacionit të pikës 7.1 (a,c dhe d), të depozitojnë pranë zyrave përkatëse të EKB-së dokumentacionin shtesë të mëposhtëm:

a)Kopje të kontratës së qiramarrjes (me ish-ndërmarrjen komunale banesa) ose/autorizim apo vendim të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv (origjinale ose të noterizuara).

b)Vendim gjykate për kthim prone pronarit të ligjshëm, ose/dokument të lëshuar nga ish-NK Banesave për kalim prone në favor të pronarëve;/ose/vendim i kthimit të pronës nga Komisioni i Kthimit të Pronave pronarit të ligjshëm (origjinale ose të noterizuara)".

3.Pas pikës 7/2 shtohen pikat 7/2/1, 7/2/2, 7/2/3 dhe 7/2/4, respektivisht me këtë përmbajtje:

"7/2/1 Përveç sa më sipër përfitojnë kredi me interes 0% edhe:

a) Familjet që kanë qenë qiramarrës në ish-pronë private, të cilët vazhdojnë të banojnë në po të njëjtën shtëpi pronar, por që për arsye ekonomike janë ndarë nga trungu familjar para vitit 1992;

b) Familjet që banojnë në banesat e emigrantëve politikë dhe ekonomikë;

c) Familjet qiramarëse banuese në ish-pronë private në qiramarrje me pronarin, para vitit 1992.

7/2/2 Për familjet qiramarrëse në ish-pronë private, në të cilat njëri nga pjesëtarët e familjes së certifikatës së 1992 është shkëputur nga trungu familjar dhe ka përfituar pronë, struktura që do të përfitojë kjo familje të llogaritet vetëm për pjesëtarët e tjerë që mbeten në certifikatën e 1992.

7/2/3 Për familjet e divorcuara përfitojnë të dy familjet e krijuara mbas divorcit, por

përllogaritja e përfitimit do të bëhet referuar certifikatës familjare të vitit 1992, duke pasur parasysh edhe ndarjen e familjes.

7/2/4 Enti Kombëtar i Banesave, në dosjet që krijon për çdo qytetar të përfshirë në pikën 7 të këtij udhëzimi, krahas dokumentacionit të pikave 7.1 dhe 7.2 të depozitojë edhe formularin e verifikimit në vend, të bërë nga komisionet e ngritura prej tij.

4.Pika 7/3 ndryshon si më poshtë:

"7/3 Listat e familjeve që përfshihen në pikën 7, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin e plotë dhe janë miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave për përfitimin e kredisë me interes 0%, i dërgohen nga ky i fundit bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Financave dhe MPPT. Pas konfirmimit nga banka për lidhjen e kontratave, EKB njofton menjëherë bashkitë respektive dhe pronarin e banesës".

5.Pika 7/4 ndryshon si më poshtë:

"7/4 Listat do të përmbajnë emrin, atësinë, mbiemrin e kryefamiljarit, strukturën e apartamentit që përfiton, vlerën e kredisë që përfiton, sipas certifikatës familjare të muajit dhjetor 1992, e normave të strehimit referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 3.12.2004."

6.Pika 8 ndryshon si vijon:

"8.Lista e familjeve që përfitojnë kredi me interes 3%, e miratuar me vendim të këshillit bashkiak, brenda kuotave që përcakton MPPT, bazuar në buxhetin vjetor, i dërgohet bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrin e Financave dhe Ministrin e Punëve Publike dhe Transportit. Formati i listës emërore të hartohet nga njësitë vendore sipas formatit tip bashkëlidhur. Për llogaritjen e numrit të familjeve, për çdo bashki, që përfitojnë kredi me interes 3% MPPT bazohet në numrin total të përfituesve dhe në përqindjen që zënë aplikimet për strehim në një bashki në raport me totalin. Kjo ndarje përditësohet sa herë ka informacione nga bashkitë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të MPPT. Informacioni në faqen e internetit të MPPT përbën njoftim zyrtar dhe mund të përdoret nga bashkitë dhe banka e përzgjedhur".

7. Pika 11 ndryshon si vijon:

"11.Për çdo qytet, kufiri maksimal i kreditimit për familje llogaritet sa 80% e vlerës së apartamentit të blerë në treg sipas çmimeve kufij që jepen në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Në rast se familja kërkon të kreditohet për një vlerë më të madhe, diferenca e kredisë paguhet me interesin e bankës. Të dhënat sipas tabelës nr.2 përditësohen çdo vit sipas vlerave të tregut të lirë të banesave që miratohen me udhëzimin e Këshillit të Ministrave dhe publikohen në faqen e internetit të MPPT".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Lidhja nr.2 – Formati i listës emërore

Nr. rendor	Emri/atësia /mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Statusi social i familjes	Statusi i punësimit të k/familjarit	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton	Të ardhurat mujore familjare të deklaruara	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9

Shënim.
1.Lista emërore duhet të jetë e shtypur (jo e shkruar me shkrim dore).
2.Çdo faqe e listës emërore duhet të ketë vulën e Këshillit Bashkiak.
3.Shkresa përcjellëse dërgohet me firmë të kryetarit të bashkisë në adresë të:
BKT, Banka Kombëtare Tregtare
Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë
4.Shkresa përcjellëse duhet të përmbajë numrin total të listës së familjeve që i dërgohen bankës si dhe faktin, nëse kjo është listë përfundimtare apo pjesore. Kopje e shkresës përcjellëse, pa listën emërore, i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
5.Në kolonën 2 vihet emri, emri i babait dhe mbiemri i kryefamiljarit.
6.Në kolonën 3 përbërja e familjes sipas certifikatës së gjendjes familjare.
7.Në kolonën 4 struktura e apartamentit që përfiton sipas normave të strehimit.
8.Në kolonën 5 me status social të familjes dhe/ose profesionin kuptohet (neni 5 i ligjit nr.9232, datë 13.5.2004):
- Familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divercuar dhe ka në ngarkim fëmijë;
- individët me aftësi të kufizuara;
- familjet me shumë fëmijë;
- çiftet e reja me moshë totale deri në 55 vjeç;
- individët me statusin e jetimit.
Vini re! Përcaktimi i "pa strehë", nuk është i vlefshëm.
9.Në kolonën 6 vendoset statusi i punësimit të kryefamiljarit ose personit që ka aplikuar si p.sh. punëtor, nëpunës, arsimtar, mjek, biznes i vogël etj.
10.Në kolonën 7 vendosen vlerat, sipas tabelës nr.2, për strukturën e apartamentit.
11. Në kolonën 8, vendosen të ardhurat mujore që ka deklaruar familja.

Qarku	Qarku Berat					Qarku Diber				Q. Durres	
Bashkia	Berat	Çorovodë	Kucove	Poliçan	Urë Vajgurore	Bulqizë	Burrel	Klos	Peshkopi	Durresi	Fushe Kruje
Nr. Rendor	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	37,281	15,946	32,672	20,848	29,750	38,610	38,860	35000	40,410	73,968	52,230
G	1,565,802	669,732	1,372,224	875,616	1,249,500	1,537,620	1,548,120	1,470,000	1,697,220	3,106,656	2,193,660
1+1	1,864,050	797,300	1,633,600	1,042,400	1,487,500	1,830,500	1,843,000	1,750,000	2,020,500	3,698,400	2,611,500
2+1	2,311,422	988,652	2,025,664	1,292,576	1,844,500	2,269,820	2,285,320	2,170,000	2,505,420	4,586,016	3,238,260
3+1	2,982,480	1,275,680	2,613,760	1,667,840	2,380,000	2,928,800	2,948,800	2,800,000	3,232,800	5,917,440	4,178,400

Qarku	Qarku Durres				Qarku Elbasan						
Bashkia	Kruje	Manzë	Sukth	Shijak	Belsh	Cerrik	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin	Prrenjas
Nr. Rendor	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	52,230		41,000	43,794	34,300	39,658	48,984	38,666	42,240	39,796	38,650
G	2,193,660	0	1,722,000	1,839,348	1,440,600	1,665,636	2,057,328	1,623,972	1,774,080	1,671,432	1,623,300
1+1	2,611,500	0	2,050,000	2,189,700	1,715,000	1,982,900	2,449,200	1,933,300	2,112,000	1,989,800	1,932,500
2+1	3,238,260	0	2,542,000	2,715,228	2,126,600	2,458,796	3,037,008	2,397,292	2,618,880	2,467,352	2,396,300
3+1	4,178,400	0	3,280,000	3,503,520	2,744,000	3,172,640	3,918,720	3,093,280	3,379,200	3,183,680	3,092,000

Qarku	Qarku Fier						Qarku Gjirokaster				
Bashkia	Ballsh	Divjakë	Fier	Lushnje	Patos	Roskovec	Gjirokaster	Kelcyre	Libohovë	Memaliaj	Përmet
Nr. Rendor	23	24	25	26	27	28	29	30	31	32	33
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	34,800	46,671	56,094	41,202	31,692	36,772	48,035	23,250	29,400	9,340	27,456
G	1,461,600	1,960,182	2,355,948	1,730,484	1,331,064	1,544,424	2,017,470	976,500	1,234,800	392,280	1,153,152
1+1	1,740,000	2,333,550	2,804,700	2,060,100	1,584,600	1,838,600	2,401,750	1,162,500	1,470,000	467,000	1,372,800
2+1	2,157,600	2,893,602	3,477,828	2,554,524	1,964,904	2,279,864	2,978,170	1,441,500	1,822,800	579,080	1,702,272
3+1	2,784,000	3,733,680	4,487,520	3,296,160	2,535,360	2,941,760	3,842,800	1,860,000	2,352,000	747,200	2,196,480

Qarku	Q. Gj.	Qarku Korce						Qarku Kukes			Q. Lezhe
Bashkia	Tepelenë	Bilisht	Ersekë	Korce	Leskovik	Maliq	Pogradec	B.Curri	Krume	Kukës	Lac
Nr. Rendor	34	35	36	37	38	39	40	41	42	43	44
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	20,260	35,680	24,959	45,500	20,243	29,406	56,094	27,300	27,060	34,030	40,552
G	850,920	1,498,560	1,048,278	1,911,000	850,206	1,235,052	2,355,948	1,146,600	1,136,520	1,429,260	1,703,184
1+1	1,013,000	1,784,000	1,247,950	2,275,000	1,012,150	1,470,300	2,804,700	1,365,000	1,353,000	1,701,500	2,027,600
2+1	1,256,120	2,212,160	1,547,458	2,821,000	1,255,066	1,823,172	3,477,828	1,692,600	1,677,720	2,109,860	2,514,224
3+1	1,620,800	2,854,400	1,996,720	3,640,000	1,619,440	2,352,480	4,487,520	2,184,000	2,164,800	2,722,400	3,244,160

Qarku	Qarku Lezhe				Qarku Shkoder					Q. Tirane	
Bashkia	Lezhe	Mamurras	Rrëshen	Rubik	Fushë Arrëz	Koplik	Puke	Shkoder	Vau i Dejes	Kamëz	Kavajë
Nr. Rendor	45	46	47	48	49	50	51	52	53	54	55
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	52,200	27,247	39,193	28,000	6,922	39,256	13,290	51,405	26,350	49,980	58,327
G	2,192,400	1,144,374	1,646,106	1,176,000	290,724	1,648,752	558,180	2,159,010	1,106,700	2,099,160	2,449,734
1+1	2,610,000	1,362,350	1,959,650	1,400,000	346,100	1,962,800	664,500	2,570,250	1,317,500	2,499,000	2,916,350
2+1	3,236,400	1,689,314	2,429,966	1,736,000	429,164	2,433,872	823,980	3,187,110	1,633,700	3,098,760	3,616,274
3+1	4,176,000	2,179,760	3,135,440	2,240,000	553,760	3,140,480	1,063,200	4,112,400	2,108,000	3,998,400	4,666,160

Qarku	Qarku Tirane			Qarku Vlore						
Bashkia	Rrogozhine	Vorë	Tirane	Delvinë	Himarë	Konispol	Orikum	Sarande	Selenicë	Vlore
Nr. Rendor	56	57	58	59	60	61	62	63	64	65
vlerat e tregut te lire (viti 2010)	37,000	50,000	84,750	39,800	53,400	34,170	48,600	49,500	25,200	59,101
G	1,554,000	2,100,000	3,559,500	1,671,600	2,242,800	1,435,140	2,041,200	2,079,000	1,058,400	2,482,242
1+1	1,850,000	2,500,000	4,237,500	1,990,000	2,670,000	1,708,500	2,430,000	2,475,000	1,260,000	2,955,050
2+1	2,294,000	3,100,000	5,254,500	2,467,600	3,310,800	2,118,540	3,013,200	3,069,000	1,562,400	3,664,262
3+1	2,960,000	4,000,000	6,780,000	3,184,000	4,272,000	2,733,600	3,888,000	3,960,000	2,016,000	4,728,080